



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 223, Datë 10.07.2023

MBI

**ZGJATJEN E AFATIT TË VENDIMMARJES SË BORDIT TË ERE-S NË LIDHJE ME  
TRANSFERIMIN E PJESSHËM DHE MODIFIKIMIN E PJESSHËM TË LICENCËS  
PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE, VETËM PËR HEC-IN ZALLI I  
BULQIZËS, NGA SHOQËRIA “TEODORI 2003” SH.P.K. TE SHOQËRIA  
“KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” SH.P.K.**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 14, pika 3, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrik, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, i ndryshuar; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96 datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 10.07.2023, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 1202/34 prot, datë 06.07.2023, të Drejtorive Teknike të ERE-s “Mbi zgjatjen e afatit të vendimmarjes së Bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k. te shoqëria “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” sh.p.k.”,

**Konstatoi se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin 161, datë 09.05.2023, vendosi të fillojë procedurën për transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nr. 87, Seria PV09K, miratuar me vendimin e bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 04.11.2009, nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k. te shoqëria “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” sh.p.k., vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, me kapacitet të instaluar 5.350 MW.
- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 11.05.2023 dhe 12.05.2023). Ky njoftim u botua dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s. Brenda afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga palë të treta, janë paraqitur në ERE objeksione ndaj këtij vendimi, nga palët e interesuara.
- Në zbatim të nenit 10, pika 13, të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, e ndryshuar, ERE me shkresën nr. 1202/28 prot., datë 21.06.2023, i dërgoi shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k. objeksionet si më sipër, duke i kërkuar të paraqesë shpjegimet përkatëse për secilin prej tyre.

- Me qëllim sqarimin e të gjitha objeksioneve dhe kërkesave të depozituara në lidhje me vendimin e bordit të ERE-s nr. 161, datë 09.05.2023, u vlerësua mbajtja e një seance dëgjimore, e cila u zhvillua në ambientet e ERE-s në datën 03.07.2023, mes përfaqësuesve të ERE-s, Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k., shoqërisë “TEODORI” sh.p.k., shoqërisë “ALBANIA HYDRO INVESTEMENTS HOLDING” sh.p.k., Bankës “OTP ALBANIA BANK” sh.a. dhe Znj. SH.N, aksionere e shoqërisë “TEODORI 2003” sh.p.k..
- Për gjithë sa më sipër, për të analizuar të gjitha objeksionet, sqarimet e dhëna nga aplikuesi mbi këto objeksione, e po ashtu, me qëllim shqyrtimin e pretendimeve që palët paraqitën në këtë seancë apo depozitim të dokumentacionit në vijim të seancës së mbajtur, çka mund të sjellë nevojën e zhvillimit të një korrespondence të mëtejshme dhe/ose seance dëgjimore, vlerësojmë zgjatjen e vendimmarrjes së bordit të ERE-s për transferimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, nga shoqëria “TEODORI 2003” sh.p.k. te shoqëria “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” sh.p.k.
- Në nenin 14, pika 3, të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike* e ndryshuar, parashikohet se bordi mund të vendosë rast pas rasti për zgjatjen e afatit për marrjen e vendimit përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë por jo më shumë se 30 ditë.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

#### **Vendosi:**

1. Të zgjasë deri në 30 (tridhjetë) ditë afatin e vendimmarrjes përfundimtare të bordit të ERE-s në lidhje me transferimin e pjesshëm dhe modifikimin e pjesshëm të licencës për prodhimin e energjisë elektrike, vetëm për HEC-in Zalli i Bulqizës, nga shoqëria “TEODORI 2003” shpk te shoqëria “KONCESIONARE TËRNOVË ZALL BULQIZË” sh.p.k.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “TEODORI 2003” sh.p.k., shoqërinë “TEODORI” sh.p.k., shoqërinë “ALBANIA HYDRO INVESTEMENTS HOLDING” sh.p.k., Bankën “OTP ALBANIA BANK” sh.a. dhe palët e intersit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI**

**Petrit AHMETI**